	Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"
Pranuar më dt.	20.01.2023
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
308	01-46/A

Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren



DORACAK PËR STUDENTË

Të Universitetit "Ukshin Hoti" – Prizren

PËRMBAJTJA:

Fjala e Rektorit	3
Historiku dhe lokacioni	4
Informacione akademike	6
Procedurat e diplomimit	9
SMU dhe shërbimi studentor	11
Qendra e Karrierës dhe Alumni	14
Parlamenti dhe Këshilli e Fakulteteve	15
Biblioteka	17
Kodi Etik	18
Tarifat për studentë dhe format e pagesës	20
Linqe të rëndësishme	21

FJALA REKTORIT



Të dashur studentë!

Mirë se vini në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren.

Tani e tutje, derisa ju të diplomoni, kjo do të jetë shtëpia juaj e dytë. Vendimi juaj për të studiuar në këtë Universitet është vendim i drejtë, ndërsa për ne është edhe njëkohësisht obligim që t'u ofrojmë të gjitha kushtet e nevojshme gjatë studimeve.

Ky Doracak ofron informacion thelbësor që do t'ju nevojitet si student i Universitetit "Ukshin Hoti" në Prizren. Doracaku ofron të gjitha informacionet e kërkuara për të gjitha fazat e ciklit të jetës së studentit duke filluar nga: Pranimi, përparimi, njohja dhe certifikimi, përfshirë të gjitha rregulloret, të drejtat dhe përgjegjësitë e studentëve, të drejtën e ankesës së studentit, veprimet që duhen ndërmarrë për shkelje disiplinore, përgjegjësitë e nëpunësve dhe komisioneve përkatëse, si dhe ndëshkimet që mund të

vendosen. Pra është një përmbledhjeje e akteve që e rregullojnë raportin e studentit me Universitetin.

Qendra e Karrierës dhe Alumni, do të jetë me juve që nga pranimi derisa të diplomoheni e të punësoheni. Ne do të kujdesemi që ju të mbani lidhjet përherë me Universitetin, dhe ju ftojme që të jeni pjesë e shoqatës Alumni sapo të diplomoheni.

Me punët që janë bërë e po bëhen, ky Universitet po hyn në një epokë të re, si Universiteti konkurrues serioz me Universitetet në vend dhe më gjerë.

Krahas kryerjes së obligimeve si studentë, ne ju ftojme të jeni aktiv në organet që përfaqësoheni dhe në çdo aspekt, sepse vetëm bashkërisht mund ta bëjmë Universitetin me të cilin të gjithë do të krenohemi.

Suksese!

Prof. Asoc. Dr. Samedin Krrabaj – Rektor

HISTORIKU DHE LOKACIONI

Jetësoje dijen

“Historia e shqiptarëve nuk duhet bërë nga të tjerët, por duhet njohur nga të tjerët.”

Historiku

Universiteti “Ukshin Hoti” me seli në Prizren, është themeluar me vendimin nr. 01/87 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, më 09.10.2009 si Universiteti i dytë publik në Republikën e Kosovës, i cili filloi me gjeneratën e parë të studentëve në vitin akademik 2009/2010, përkatësisht më 01.10.2010.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, më 30.05.2013, miratoi Statutin e Universitetit “Ukshin Hoti” me seli në Prizren.

Universiteti “Ukshin Hoti”, me gjashtë njësitë akademike që ka, aktualisht ofron studime në ciklin baçelor dhe master, ndërsa në bazë të statutit, mund të organizojë edhe studime doktorale. Përveç studimeve në gjuhën mësimore shqipe, Universiteti ofron studime edhe në gjuhën mësimore turke dhe boshnjake.

Universiteti trashëgon përvojën e ish-Shkollës së Lartë Pedagogjike, degë e ndarë e Prishtinës, që funksiononte nga tetori i vitit 1961, e që më vonë u shndërrua në Fakultetin e Edukimit - dega në Prizren.

Qyteti i Prizrenit, selia e këtij Universiteti, me Ligjin Nr. 06L/-012 neni 4 pika 2 është shpallur **Kryeqyteti Historik i Republikës së Kosovës**, i cili njihet normalisht përveç për historikun e tij të pasur po ashtu edhe për multietnicitetet dhe trashëgimi e kulturë jo vetëm në Republikën e Kosovës por edhe me gjerë.

Qyteti i Prizrenit po ashtu është qyteti i dytë më i madh pas Prishtinës, i cili në bazë të statistikave është qyteti më i vizituar në vend. Shtrihet në pjesën jugore të Republikës së Kosovës. Duke qenë qyteti më i afërt me Republikën e Shqipërisë, për shtetasit e saj, ky qytet por edhe Universiteti “Ukshin Hoti” janë mjaft joshës dhe atraktivë.

Universiteti “Ukshin Hoti” në Prizren (tutje referuar si UUHP), ka nisur punën në vitin 2010 pas vendimit të Qeverisë së Kosovës për themelim. Selia e Universiteti është në Prizren, njëri nga qytetet më të lashta të Kosovës. Universiteti i Prizrenit është Universiteti i dytë publik në Kosovë. Në vitin 2010 numri i studentëve ishte afër 1.700, ndërsa tani në vitin 2020 numri i studentëve është rreth 4035 studentë aktiv. Universiteti është i akredituar nga viti 2010. Për herë të fundit i është nënshtruar procesit të akreditimit vitin e kaluar dhe është ri-akredituar. Momentalisht Universiteti ofron studime në ciklin Baçelor dhe Master.


Mësimdhënia

Mësimdhënia si proces planifikohet, drejtohet, organizohet nga mësimdhënësi sipas stileve të të nxëniet dhe me pjesëmarrjen aktive të studentëve, ku përvetësohen njohuri, përdoren metoda, teknika ndërvepruese, zhvillohen aftësitë, shkathtësitë, formohen shprehitë si dhe ndodhi formimi tërësor i personalitetit të studentëve. Dhe ky proces është mjaft kompleks, veprimtari e rëndësishme shoqërore dhe me tepër përgjegjësi.

Lokacioni

Universiteti ndodhet në pjesën perëndimore të qytetit të Prizrenit. Prizreni është një nga qytetet më të vjetra të Republikës së Kosovës. Afër Universitetit ndodhet Parku i Qytetit, i cili frekuentohet nga studentët gjatë gjithë kohës.

Adresa: «Rruga e shkronjave», nr. 1, 20000 Prizren



INFORMACIONE AKADEMIKE

Fakultetet-Programet që kanë

Programet e ciklit të parë të akredituara nga AKA janë:

- **Fakulteti i Ekonomik me drejtimet:**
 - Administrim Biznesi (Bsc)
 - Menaxhment Ndërkombëtar (Bsc)
- **Niveli Master**
 - Kontabilitet dhe Auditim
 - Administrim Biznesi
- **Fakulteti Juridik; (Bsc)**
- **Fakulteti i Shkencave kompjuterike me drejtimet:**
 - Dizajn i Softuerit (Bsc) dhe
 - Teknologji e Informacionit dhe Telekomunikimit; (Bsc)
- **Niveli Master**
 - Shkenca Kompjuterike dhe Teknologji Komunikimi (Msc)
- **Fakulteti i Edukimit me programet:**
 - Programi Fillor (Bsc) dhe
 - Parashkollor (Bsc)
- **Fakulteti i Filologjisë:**
 - Gjuhë dhe Letërsi Shqipe (Bsc)
 - Gjuhë Angleze (Bsc)
 - Gjuhë Gjermane (Bsc)
- **Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit me programet:**
 - Agrobiznes (Bsc)
 - Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit (Bsc)

Njëkohësisht, brenda një periudhe afatmesme, Universiteti “Ukshin Hoti” Prizren, planifikon të hap edhe programet e studimeve të doktoratës.

Progresi akademik

Studimet themelore baçelor, deri në përfundimin e studimeve, zgjasin tri deri në katër vjet, përkatësisht gjashtë semestra, me kërkesën që të plotësohen së paku 180 përkatësisht 240 kredi. Studenti duhet t’i sigurojë për çdo vit të studimeve 60(gjashtëdhjetë) kredi nga provimet e dhëna në lëndët obligative dhe ato zgjedhore.

Studenti ka të drejtë ta regjistrojë vitin e dytë të studimeve, nëse i ka dhënë 70% të provimeve, nga numri i përgjithshëm i provimeve, ose t’i ketë fituara 41 kredi nga lëndët mësimore, të vitit të parë të studimeve.

Vitin e tretë të studimeve, studenti mund ta regjistrojë, nëse i ka kryer 35% të provimeve, përkatësisht nëse ka fituar 20 kredi, nga numri i përgjithshëm i kredive të lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.

Vitin e katërt, studenti mund ta regjistrojë, nëse ka dhënë 30% të provimeve nga numri i përgjithshëm, përkatësisht, nëse ka fituar 18 kredi, nga lëndët mësimore të vitit të tretë të studimeve.

Studenti nuk mund të hyjë në provime të vitit të dytë, pa i përfunduar provimet e vitit të parë; gjithashtu studenti i vitit të dytë nuk mund të hyjë në provimet e vitit të tretë pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të dytë, si dhe studenti i vitit katërt nuk mund të hyjë në provimet e vitit të katërt, pa i përfunduar të gjitha provimet e vitit të tretë.

Studenti i cili në afatin e shtatorit nuk i fiton kreditë e parapara me nenin 22 të kësaj Rregulloreje, për regjistrimin e vitit vijues, duhet ta përsërisë regjistrimin e vitit akademik.

- **Prezenca e studentit**

Çdo ligjërues është i obliguar të mbajë evidencë të pranisë së studentëve në orën mësimore. Formularët e pranisë do t'u jepen në fillim të muajit dhe të njëjtat duhet të dorëzohen në Dekanat në fund të muajit. Ligjëruesi është i obliguar që këta formularë t'i ketë me vete gjatë çdo orë mësimore si dëshmi për respektimin e Rregullores gjatë monitorimit nga Dekanati. Secili student duhet të ndjekë të paktën 70% të numrit të përgjithshëm të orëve të lëndës (ligjërata dhe ushtrime), që të mund të hyjë në provim.

Mënyra e studimeve

Mësimi realizohet nëpërmjet ligjëratave, ushtrimeve teorike, ushtrimeve laboratorike, mësimi praktik në institucionet publike, private, seminareve, testeve, konsultimeve profesionale, punimeve të pavarura të studentëve, si dhe ekskursioneve me karakter mësimor-shkencor.

- **Afati i provimeve**

Provimet për studimet themelore mbahen në afatet dhe datat e përcaktuara dhe të publikuara në tabelën e njoftimeve dhe të faqes zyrtare të internetit.

Afatet e rregullta të provimeve janë:

Afati i janarit – fillon prej 20 janar deri më 15 shkurt

Afati i qershorit – fillon prej 6 qershorit deri më 30 qershor

Afati i shtatorit – fillon prej 7 shtator deri më 30 shtator

Senati dhe Këshilli i Fakultetit, mund të lejoj me vendim të veçantë edhe ndonjë afat tjetër të provimeve, si afat të jashtëzakonshëm.

- **Notimi**

Provimi vlerësohet maksimalisht deri në 100 pikë. Nota përfundimtare në mbrojtjen e provimit nxjerret sipas pikëve të grumbulluara në pasqyrën tabelare si vijon:

Nr.	Nota	Përshkrimi
1.	Dhjetë (10) dhe nëntë (9)	Shkëlqyeshëm

2.	Tetë (8)	Shumë mirë
3.	Shtatë (7)	Mirë
4.	Gjashtë (6)	Mjaftueshëm
5.	Pesë (5)	Pamjaftueshëm

Format e mbrojtjes së provimit janë:

- Provimi me shkrim;
- Provimi gojazi;
- Provimi me shkrim dhe gojazi;
- Provimi me test;
- Provimi praktik.

Provimet e kombinuara me shkrim dhe gojazi, mbahen brenda afatit, në të kundërtën provimi anulohet nga dekanati.

Nota e vlerësimit shënohet në sistemin SMU dhe në fletëparaqitje nga mësimmshënësi ose komisioni.

PROCEDURAT E DIPLOMIMIT

- **Procedurat e diplomimit baçelor**

Studimet baçelor në Universitetin “Ukshin Hoti” në Prizren, përfundojnë me mbrojtjen e punimit të diplomës, në pajtim me programin e studimeve.

Studenti i nënshtrohet provimit përfundimtar në baçelor pasi t’i ketë përfunduar më parë të gjitha provimet e parapara dhe t’i ketë grumbulluar së paku 240 përkatësisht 180 kredi të nevojshme, në emër të provimeve të dhëna, si dhe pasi t’i ketë kryer të gjitha obligimet tjera të parapara me Ligj, Statut si dhe me Rregullore.

Mbrojtja e provimit përfundimtar(diplomës) është publike, bëhet para komisionit prej tre anëtarësh, komisionin e cakton dekani ose prodekani, në bashkëpunim me shefat e programeve mësimore. Të drejtë mentorimi kanë profesorët me titull shkencor, doktor i shkencave.

Hapat të cilët duhet të ndiqen për mbrojtjen e punimit të diplomës janë:

1. Paraqitja për mbrojtjen e provimit përfundimtar bëhet në Administratën e Fakultetit, te referenti apo te personi i autorizuar për këtë çështje.
2. Formularët për paraqitje, merren te personi i autorizuar për këtë.
3. Formulari plotësohet me të gjitha të dhënat për studentin, që paraqitet për mbrojtjen e provimit përfundimtar.
4. Krahas kërkesës për paraqitjen e provimit përfundimtar, studenti paraqet edhe:

1. Indeksën ose ID kartelën.
2. Fletëparaqitjen për provimin përfundimtar e cila merret të referenti për çështje të studentëve,
3. Dy ditarët e mësimi praktik,
4. Projekt-prezentimi.

Për detajet tjera për procedurat e diplomimit i gjeni në Rregulloren për studime bachelor.

- **Procedurat e diplomimit master**

Studimet master në Universitet përfundojnë me mbrojtjen e punimit master, në pajtim me programin e studimeve. Studenti i cili i ka kryer obligimet e parapara me plan-program mësimor të studimit përkatës, fiton të drejtën të marrë temën master.

Punimi master punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike dhe praktike të arritura gjatë kohës së studimeve mund të aplikohen me sukses për zgjidhjen e problemeve kërkimore në fushën shkencore për të cilën është përcaktuar studenti.

Fakultetet kanë Komisione për filtrimin e temave dhe tezave të punimit ku vlerësimi nga Komisioni dhe propozimet dërgohen për shqyrtim në Këshillin e Fakultetit i cili miraton titujt e propozuar nga mësimdhënësit dhe lejon hartimin e punimit master për kandidatët. Me këtë rast Dekani në koordinim me Këshillin Mësimor-Shkencor të Fakultetit emëron mentorin i cili e udhëheq studentin gjatë punës për punimin e diplomës ose tezës master.

Punimi master duhet të ketë prej 50-80 faqe të formatit A4. Referencat shënime në fund të faqes nuk përfshihen në këtë përlllogaritje. Punimi duhet të jetë me përmbajtje origjinale dhe të ngërthejë në vete fushën kërkimore-shkencore sipas programit studimor përkatës. Lloji i shkrimit në Times New Roman, madhësia e shkronjave në tekst duhet të jetë 12, hapësira midis rreshtave (space line) duhet të jetë 1.5. Punimi dorëzohet në 5 (pesë) kopje në lidhje të fortë në administratën e njësisë akademike ku studion kandidati 15 (pesëmbëdhjetë) ditë para datës së mbrojtjes së punimit master.

Pas dorëzimit të dorëshkrimit të punimit master për vlerësim nga Dekani i Fakultetit, me propozim të Këshillit të Fakultetit përkatës, ngrit komisionin për vlerësimin e punimit master në afatin prej 30 (tridhjetë) ditësh prej ditës së paraqitjes së kërkesës nga kandidati.

Për detajet tjera për procedurat e diplomimit i gjeni në Rregulloren për studime master.

SMU DHE SHËRBIMI STUDENTOR

- **Aplikimi**

Në kuadër të Universitetit funksionon Sistemi për Menaxhimin Universitar (i njohur me shkurtesën SMU) Aplikimi për të fituar statusin e studentit në Universitetin tonë bëhet përmes SMU-së (www.smu.uniprizren.com), plotësimi i formularit dhe taksa e aplikimit (sipas udhëzimit administrativ të MASHT-it), bëhet online dhe dorëzohen tek shërbimi i studentëve pranë Fakultetit ku aplikoni.

UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN
SMU - Sistemi i Menaxhimit Universitar

AFATI PRANUES ËSHTË I HAPUR.
02.07.2019 - 17.07.2019

07 DAYS | 12 HOURS | 48 MINS | 40 SECS

- Aplikimi online**
Aplikimi online për statusin e studentit
- Aplikimi per diplome**
Aplikimi online për diplome
- Aplikimi për transfer/indeks**
Aplikimi online për transfer/indeks në Universitetin e Prizrenit
- Pagesat**
Shërbimi i pagesave për të gjitha llojet e pagesave

Aplikuesi i cili pranohet bënë fotografimin dhe i krijohet një qasje në sistemin e SMU-së, dhe pajiset me ID-kartelën studentore.

- **Shërbimi studentor**

Ky shërbim është dera e parë e komunikimit të studentit në Universitet dhe njëkohësisht shërben si zyre e informacionit për studentët.

Që nga aplikimi në Universitet si kontakt i parë është shërbimi i studentëve (referenti), tek të cilët mund të kryejnë këto shërbime:

Dorëzimi i dosjes për aplikim

Krijimi i dosjes fizike për studentët

Të gjitha llojet e pagesave (Për provim pranues, për semestër, për pagesën e mbrojtjes së temës së diplomës, për provime plotësuese për regjistrim, për provime në studime master, për Certifikatë të Notave, për Certifikatë të Diplomës, për secilin provim të pranuar me rastin e transferimit, për diplomë, për diplomë Duplikatë, për ndërrim të Fakultetit/departamentit).

Lëshimi i vërtetimeve dhe të certifikatave të notave

Kryejnë çregjistrimin, suspendimin apo përjashtimin e studentit
Kryejnë procedurat administrative të diplomimit të studentëve.

Orari i punës së referentëve është nga ora 8:00 deri në ora 16:00 në çdo ditë punë, zyrët e referentëve i gjeni në hollin e njësishë përkatëse.

- **Zyra e teknologjisë informative – IT**

Në këtë zyre ofrohen shërbime teknike rreth përdorimit të sistemeve dhe shërbime të tjera të cilat janë në kuadër të IT-së.

Si shërbim zyra e IT-së e ka edhe shërbimin online i cili është i vendosur në SMU ku mund të marrin përgjigje përmes e-mailit të cilët i dërgojnë studentët apo edhe për ata studentë të cilët paraqiten në zyre për të kërkuar një shërbim të tillë.

Shërbime mbështetëse të cilat i hasin studentët gjatë punës në sisteme.


Në kuadër të shërbimeve të IT-së janë edhe pajisja me ID-Kartela studentore.

Zyra e IT-së gjendet në Fakultetin e Edukimit, kati II, nr. 130 dhe punon nga ora 8:00 – 16:00.


- **Qasja në SMU**

Në SMU mund të qaseni me linkun: www.uni-prizren.com

Do të paraqitet dritarja ku duhet të futni të dhënat e kërkuara:



Pas qasjes në sistem do të duket si në vijim llogaria juaj në sistemin e SMU-së .



Ju në këtë system mund të:

- Ndryshoni fjalëkalimin, nr.kontaktues dhe e_mail,
- Regjistroni semestrin dhe lëndët-ka dy nënmeny për regjistrimin e lëndëve obligative dhe zgjedhore për semestër dhe semestrat që i keni regjistruar deri në atë moment;
- Paraqitni provimet dhe të gjeni listën e rezultateve-jep mundësin e paraqitjes së provimeve për afat të caktuar dhe temës së diplomës si dhe mund ti shikoni rezultatet e provimeve për ato lëndë të cilat i keni paraqitur;
- Shkarkoni pagesa-është opcioni i shkarkimit të pagesave online sipas Udhëzimit Administrativ të lëshuar nga MASHT-i, pagesat e semestrave janë të përcaktuar me afate sipas Rregulloreve përkatëse;
- Hapni transkriptën e notave-është opcioni ku mund t'i shikoni notat pozitive të cilat i keni marrë deri në atë moment dhe mesatarja;
- Shkarkoni materialet mësimore-është opcioni ku mund t'i shkarkoni rezultatet, materialet mësimore (ligjëratat, literatura, ushtrime dhe syllabuset);
- Merrni njoftime-është opcioni ku vijnë të gjitha njoftimet për hapje të sistemit për paraqitje të provimeve, të afateve për diplomim dhe njoftimet tjera të cilat i ngarkojnë profesorët, Dekanati etj.;
- Keni qasje në oraret e ligjëratave dhe provimeve-është mundësia e shikimit të orarëve të ligjëratave dhe provimeve;

Për më shumë e keni edhe manualin e përdorimit të llogarisë së studentit në sistem. (Manuali për studentë)

Qendra Karrierës dhe Alumni - QKA

Fushëveprimtaria e QKA-së përfshin sigurimin e informacionit dhe ofrimin e zgjidhjeve për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës së studentëve dhe njëkohësisht shërben si një urë ndërlidhëse midis studentëve të Universitetit dhe tregut të punës.

Përveç atyre të poshtëshënuara QKA ofron edhe shërbime si:

Mbështet dhe krijon përgatitjen e paketës së informacionit orientues për aplikantët e interesuar si dhe për studentët aktiv.

Shqyrton dhe ofron zgjidhje ndaj kërkesave të aplikantëve dhe studentëve aktiv të UUHP

Siguron kontakte me ish-studentët (Alumnit) e UUHP-së

Mbështet çdo lloj aktiviteti që i shërben të ardhmes së studentëve.

Orari i punës: E Hënë – E Premte nga ora 8:00 – 16:00, por në raste të caktuara mund të komunikoni edhe përmes postës elektronike karriera.alumni@uni-prizren.com

- **Mentorimi apo menaxhimi**

Gjithashtu të gjithë studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” janë nën mbikëqyrjen e stafit akademik pra nën mbikëqyrjen e profesorëve.

- **Punësimi**

QKA ndihmon studentët në zhvillimin e shkathtësive të punësimit. Shërben si urë lidhëse ndërmjet Universitetit dhe studentëve.

- **Karriera**

Qendra e Karrierës dhe Alumni organizon Panairin e Karrierës, duke siguruar pjesëmarrje të institucioneve, kompanive dhe organizatave të ndryshme. Siguron listën e institucioneve, kompanive dhe organizatave të ndryshme të cilat janë të gatshme për pranimin e studentëve të Universitetit për realizimin e praktikave profesionale mësimore. Si dhe siguron marrëveshje ndërmjet institucioneve publike, kompanive dhe organizatave të ndryshme dhe Universitetit.

- **Alumni**

Organizimi i Alumnit përbëhet nga anëtarësia e thjeshtë dhe Bordi Ekzekutiv.

Anëtarësia e thjeshtë përbëhet nga student që kanë përfunduar studimet në Universitet.

Anëtarësia e Bordit Ekzekutiv të Alumnit duhet të jetë numër tek dhe jo më e vogël se 5 anëtarë.

Ky Bord mblidhet të paktën dy herë në vit dhe organizon aktivitete që kanë fokus ish-studentët e Universitetit. Bordi siguron regjistrime të përvitshme të anëtarëve të rinj.

- **Bursat**

Të gjithë nxënësit me sukses të shkëlqyer fitojnë bursën. Bursë fitojnë ata student që kanë notën mesatare mbi 9.0 që është sadopak një ndihmë për t’i mbuluar shpenzimet e tyre. Universiteti ynë kujdeset maksimalisht për studentët e vet.

- **Ofertë akademike**

Universiteti ynë në vitin akademik mundëson programe studimore në dy cikle baçelor dhe master.

PARLAMENTI DHE KËSHILLET STUDENTORE

Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët.

Interesat e studentëve do të përfaqësohen në kuadër të Universitetit me këto organe:

- Parlamenti i studentëve në nivel të Universitetit;
- Këshilli i studentëve në nivel të njësisë akademike

Anëtarët për Parlamentin e studentëve dhe këshillat e studentëve do të zgjedhen në pajtim me procedurat për zgjedhje parlamentare.

Organizatat studentore kanë të drejtë të propozojnë anëtarët për parlamentin e studentëve dhe Këshillin e studentëve të njësive akademike në bazë të rezultateve të zgjedhjeve në çdo dy (2) vjet.

Mandati i anëtarëve të Parlamentit të studentëve dhe Këshillit të studentëve të njësive akademike zgjat dy (2) vjet, pa të drejtë të rizgjedhjes.

Parlamenti i studentëve dhe këshillat e studentëve të njësive akademike ushtrojnë detyra në bazë të parimit të shumicës së votave.

Parlamenti i studentëve është organi më i lartë i përfaqësimit të studentëve. Numri i tërësishëm i anëtarëve të parlamentit të studentëve është nëntë (9). Këshillat e studentëve janë organet e përfaqësimit të studentëve në secilën njësi akademike.

Numri i përgjithshëm i anëtarëve të secilit Këshill të studentëve është një përqind (1%) e numrit të përgjithshëm të studentëve të rregullt të regjistruar në atë njësi akademike, me më së paku pesë (5) dhe më së shumti njëzet e një (21) anëtarë.

Aktivitetet e Parlamentit dhe Këshillave Studentore

Parlamenti dhe Këshillat studentore në vazhdimsi jashtë përgjegjësi të tyre organizojnë aktivitete të shumta kurrikulare dhe jashtëkurrikulare. Gjithashtu mundësojnë zbatimin, kënaqësinë, organizimin e aktiviteteve kulturore e sportive, në të cilat inkuadrohen të gjithë studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren.

Ja disa fotot te aktiviteteve të ndryshme:



BIBLIOTEKA QENDRORE UNIVERSITARE “UKSHIN HOTI” PRIZREN(BQU)

Biblioteka e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, funksionon që nga viti 1968, ndërsa në objektin aktual që nga viti 1972. Kjo bibliotekë posedon një fond të madh librash, ndërsa ka dy salla shumë të përshtatshme për lexim, të cilat janë në shërbim të studentëve të këtij Universiteti. Nga viti 2019-të, Biblioteka ka marrë statusin si Biblioteka Qendrore Universitare, (e njohur me shkurtesën BQU) Në kuadër të Universitetit të Prizrenit ndodhet edhe biblioteka tjetër e cila ndodhet në Fakultetin Ekonomik (e pajisur me titujt nga fusha e ekonomisë dhe e drejtësisë, po ashtu edhe libra në gjuhën turke), po ashtu, është edhe këndi Austriak i cili gjendet në hapësirat e Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit, ku është i pajisur me tituj në gjuhën gjermane në

lëminë e letërsisë dhe gjuhësisë, kurse selia qendrore e BQU-së është në objektin e Fakultetit të Edukimit. Librat të cilët ndodhen në bibliotekë janë të renditura sipas “Klasifikimit Dhjetor Universal” (KDU), sistem i cili aktualisht përdoret në gjithë rrjetin e bibliotekave.

Biblioteka ka një fond të konsiderueshëm mbi gjashtëdhjetë mijë (60 000) librash këto nga fushat e ndryshme duke u përshtatur edhe me plan-programet dhe syllabuset e njësive akademike. Në kuadër të bibliotekës është edhe qasja në bibliotekat online e cila mund të shfrytëzohet brenda kampusit të Universitetit , si:

IMF eLibrary

Cambridge e-Journal

Elgaronline

Duke University Press

ASTM COMPASS ABSTRACT

ACCEPTANCE OF LICENCE

FORM

(free access)

Hapësira e përgjithshme e BQU-së duke përfshirë edhe sallat e leximit në fakultete ka mbi 1000 (një mijë) m² . Të gjithë studentët do të njoftohen në faqen e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren për titujt më të rinj. Biblioteka Universitare e ka edhe katalogun digjital i cili është në ueb-faqen e Universitetit (<https://uniprizren.com/sq/biblioteka-1>) ku janë të renditura librat sipas sistemit të KDU-së.



KODI ETIKËS PËR STUDENTË

Kodi Etik ka për qëllim të përcaktojë rregullat e sjelljes dhe standartet etike të veprimit, për studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” në Prizren.

Studentët duhet sillen, sipas Kodit të Etikës dhe sipas këtyre parimeve:

Parimi i ligjshmërisë;

Parimi i transparencës;

Parimi i ndershmërisë dhe integritetit;

Parimi i respektit reciprok dhe kolegial;

Parimi i ndeshmërisë akademike;

Parimi i lirisë akademike dhe humumtimit;

Parimi i respektimit të të drejtave të personelit dhe të kolegëve student;

Parimi i respektimit të rregulloreve dhe vendimeve të Universitetit.

Studentët në ambientet e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, sipas këtij Kodi Etik obligohen:

Të zbatojnë orarin e mësimit, të paraqiten në mënyrë serioze dhe dinjitoze në ambientet institucionit, të përdorin fjalorë të përshtatshëm, të respektojnë personelin akademik, të mos kryer veprime dhe gjeste provokuese ndaj kolegëve dhe personelit akademik, gjithashtu të mos ofrojnë në asnjë formë, përfitime ndërhyrje, favorizime, pagesa, vet ose nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, ose favorizime të tjera.

Studentët e Universitetit “Ukshin Hoti” gëzojnë të drejtën:

Në Universitet nuk ekziston diskriminimi racor, fetar, etnik, përkatësisë politike, mosha, gjinia dhe student me aftësi të kufizuar. Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, po ashtu janë të lirë të organizojnë dhe marrin pjesë në organizata studentore, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët Brenda Universitetit. Po ashtu, janë të lirë të raportojnë në mirëbesim dhe pa frikë hakmarrjeje, çdo shkelje të këtij Kodi ose politike akademike dhe administrative të Universitetit tek drejtuesi akademik ose administrative i Universitetit.

Mosrrespektimi i Kodit Etik

Sjellje jo etike dhe të ndaluara të studentëve sipas këtij Kodi, që konsiderohen edhe si shkelje të rënda përfshijnë veprimet në vijim:

Ndërhyrje ose përçarje që pengon, dëmton misionin dhe imazhin e Universitetit. Përdorimi, shpërndarja e substancave narkotike ose të rrezikshme. Kërcënimi për ushtrimin e dhunës ose

ushtrimi i cilësdo formë të dhunës. Është e ndaluar falsifikimi ose manipulimi i shkresave dhe dokumenteve zyrtare të Universitetit, përdorimi i dokumenteve dhe të dhënave zyrtare të Universitetit për qëllime keqinterpretimi kopjimi apo tentimi për të kopjuar gjatë provimeve, kollokfjumeve, testeve ose formave të tjera gjatë vlersimit. Hyrja në kollokfjume, provime, teste apo në forma të tjera të vlersimit, në emër të dikujt tjetër si dhe përgatitja e punimit të diplomës, seminarëve dhe detyrave për studentët e tjerë. Fotografimi i testit dhe shpërndarja e testit në rrjetet sociale.

Shkeljet e rënda të Kodit të Etikës konsiderohen gjithashtu veprimet e studentëve , si në vijim:

Dhënia e shënimeve jo të sakta të organeve të Universitetit, me qëllim të përvetësimit të drejtave të caktuara të studentëve. Ndalja ose pengimi i organizmit të procesit mësimor, po ashtu edhe fotografimi, fotokopjimi, inqizimi dhe shpërndarja e paautorizuar e orës mësimore. Secili student që fyen rëndë integritetin e Fakultetit/ Universitetit, personelit akademik dhe jo akademik quhet shkelje e rëndë e Kodit Etik.

Shkelje e lehtë e Kodit Etikës nga studentët konsiderohet:

Sjellje jo e mirë dhe e pahijshme në objektet të Universitetit, ku mbahen ligjëratat, ushtrimet dhe provimet e aktivitetet e tjera. Prishja e rendit të qetësisë gjatë ligjëratave, shkatërimi i paqëllimshëm i pajisjeve mësimore dhe kryerja e aktiviteteve tjera me të cilat shkaktohen pasoja të lehta dhe i cenohet autoriteti i Universitetit.

TARIFAT PËR STUDIME DHE FORMAT E PAGESAVE

Pagesat për studime baçelor dhe master janë të përcaktuara sipas Udhëzimit Administrativ të (MASHT-it) Nr. 09/2021 për aplikimin e pagesave të studentëve në Universitet:

Të gjithë studentët lirohen nga pagesa e tarifës së studimeve baçelor kur e regjistrojnë semestrin për

herë të parë dhe lirohen nga pagesa për provim pranues.

Semestri i BSC-së, i rregullt: 25 €

Semestri i BSC-së, me korrespondencë: 125 €

Semestri i MSC-së, shkencor: 150 €

Pagesa për mbrojtjen e temës së diplomës 100 €

Për provime plotësuese për regjistrim të MSC-së: 5 €

Për provimin në studimet e MSC: 2.5 €

Për certifikatë të notave: 2.5 €

Për certifikatë të diplomës: 5 €

Për secilin provim të pranuar me rastin e transferimit: 0.50 €

Për diplomë: 5 €

Për diplomë duplikatë: 25 €

Për ndërrim të Fakultetit ose departamentit: 25 €

Opcioni pagesat është mënyra në sistem përmes së cilës studentët do të mund të gjenerojnë raportet e

pagesave që iu nevojiten gjatë studimeve. Kemi disa lloje të pagesave, të cilat do të shfaqen në listën

rënëse, pasi të keni klikuar të Zgjedh, çmimi i të cilave ndryshon sipas nivelit të studimeve dhe ato janë:

1. Për provim pranues, 2. Për certifikatë të notave, 3. Për certifikatë të diplomës, 4. Për indeks duplikat,

5. Për kërkesë për transferimin e notës ose të notave, 6. Për diplomë, 7. Për diplomë duplikat, 8. Për ndërrim të Fakultetit ose departamentit, 9. Për semestër për studentë.

LINQET E RËNDËSISHME

<https://www.uni-prizren.com/> (Linku i faqes për Universitetin)

<https://www.uni-prizren.com/studentet/#> (Linku i faqes për Parlamentin Studentor)

<https://www.facebook.com/UniversityofPrizren> (Faqja në facebook e Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren)

<https://www.facebook.com/psupz> (Faqja në facebook e Parlamentit Studentor)

[parlamentistudentor.upz](#) (Instagrami i Parlamentit Studentor)